



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-2025/25

Klinë, dt: 10.07 /25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 09.06.2025, me fillim nga ora 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti drejtorët, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, OSBE-në, Policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit.

Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2028 (ref.drejt.fin);
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt maj-qershor 2025;
5. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Jemi pesë anëtarë të pranishëm. Valmira ka konfirmuar që s'mund të marrë pjesë në këtë takim, ndërsa Mendehia nuk është ende këtu, por pritet të na bashkohet në mbledhje. A ka dikush për rend të ditës, a po pajtoheni? Kush është për?

Me 5 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Sa i përket mungesave, theksova më herët se Valmira ka konfirmuar

pamundësinë për të marr pjesë, ndërsa Mendehia pritet të na bashkohet pas pak minutash.

Pika 2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush për procesverbal?

Me 5 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2028 (ref.drejt.fin).

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa zhvilluar debat lidhur me Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028, me 5 vota PËR, rekomandoi që kjo kornizë të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt maj-qershor 2025.

Kërkesa 1.

Kërkesë nga Drejtoria e Arsimit në Klinë për ndarjen e 100 bursave për studentët e dalluar të Komunës së Klinës, si dhe për formimin e komisionit për ndarjen e tyre.

Asdren Ramadani: Është e nevojshme të rritet vlera e bursave. Unë propozoj që ajo të rritet në 80 euro, duke pasur parasysh ndikimin e inflacionit. Me 50 euro studentët nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet bazë, prandaj mbështes rritjen në këtë shumë.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Asdren. Po, Tunë Deda?

Tunë Deda: Përvendetje kryesues për ju dhe për gjithë të pranishmit. Është e rëndësishme të shqyrtohet mundësia për rritje të shumës, por pa ndikuar në uljen e numrit të përfituesve. Deri në mbledhjen e Kuvendit do të ishte mirë të merret një mendim nga ekzekutivi, për të parë nëse ka hapësirë buxhetore për këtë rritje.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit. Ne kemi një rregullore për ndarjen e bursave, nuk e di nëse është përcaktuar edhe shuma në të. A ka dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimeve të DKA-së, me 5 vota PËR, rekomandoi që, në përpjekje me mundësitë buxhetore, të rritet vlera e bursës nga 50 në 80 euro në muaj. Gjithashtu, u rekomandua që propozimet të kalojnë për

shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Kërkesa 2.

Kërkesë për mbështetje financiare për z. Shefjet Deskaj, e parashtruar nga znj. Sanije Deskaj, e cila thekson se bashkëshorti i saj, që nga viti 2022, vuan nga një sëmundje e rëndë dhe se trajtimi i tij është i kushtueshëm dhe i papërballueshëm për familjen.

Tunë Deda: Duke pasur parasysh që Shefjetin e njohim si një punëtor të përkushtuar, bamirës dhe në një situatë shumë të rëndë, kërkoj nga kolegët që këtë rast ta trajtojmë në mënyrë të veçantë. Ne e dimë se zyra e kryetarit jep ndihmë financiare në vlerën minimale prej 500 euro. Ne duhet të japim mbështetjen tonë për këtë rast.

Asdren Ramadani: Faleminderit, kryesues. Unë pajtohem me kolegun dhe dëshiroj të ndërlidhem edhe me rastin e Afërditës, që t'i ndahet edhe asaj një shumë, pasi edhe ajo ka nevojë të trajtohet për shkak të një sëmundjeje të rëndë.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Sanije Deskaj, me 5 vota PËR, rekandoi që ajo fillimisht të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe të vlerësohet mundësia e mbështetjes financiare nga ekzekutivi. Më pas, të vendoset nëse kërkesa do të procedohet për shqyrtim në Kuvend.

Kërkesa 3.

Kërkesë për mbështetje financiare për znj. Afërdita Binakaj, e parashtruar nga z. Jahë Binakaj, i cili thekson se bashkëshortja e tij vuan nga një sëmundje e rëndë dhe për trajtimin e saj është dashur të udhëtojë jashtë vendit. Për shkak të kostos së lartë të trajtimit, ai kërkon mbështetje financiare nga Komuna e Klinës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Jahë Binaka, me 5 vota PËR, rekandoi që ajo fillimisht të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe të vlerësohet mundësia e mbështetjes financiare nga ekzekutivi. Më pas, të vendoset nëse kërkesa do të procedohet për shqyrtim në Kuvend.

Kërkesa 4.

Kërkesë e parashtruar nga z. Tahir Berisha, nga fshati Gjurgjevik i Madh – Komuna e Klinës, i cili kërkon marrjen në shfrytëzim të një parcele prej 24 ari, pronë komunale, që gjendet në fshatin Gjurgjevik i Madh. Qëllimi i shfrytëzimit është zhvillimi i veprimtarisë bujqësore.

Fadil Gashi, kryesues: Kërkesa ka të bëjë me dhënien me qira të një parcele toke. Ka disa vështirësi: së pari, kemi hyrë tashmë në gjashtëmujorin e dytë dhe, së dyti, parcela nuk është e përfshirë në listën e pronave për dhënie në shfrytëzim. Ashtu si në rastet e mëparshme, të trajtohet sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme. A ka dikush

ndonjë koment? Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e z. Tahir Berisha për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit, ku të veprohet në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkesa 5.

Kërkesë e parashtruar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronesi, me anë të së cilës kërkohet ndarja e një parcele në fshatin Drenoc, që është pronë komunale. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës, kërkohet ndarja e 2,073 m² me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, në bazë të Ligjit Nr. 06/L-092 dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës, me 5 vota PËR, rekomandoi që Drejtoria përkatëse të veprojë brenda kompetencave ligjore lidhur me parcelizimin e kësaj prone, pasi Kuvendi nuk ka bazë ligjore për nxjerrjen e vendimit për parcelizimin e kësaj prone komunale.

Pika 5. Të ndryshme.

Pasi nuk pati ndonjë kërkesë apo sugjerim, kryesuesi e mylli mbledhjen duke falënderuar të gjithë anëtarët për pjesëmarrjen dhe angazhimin.

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

